



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.518/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevc, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, e paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – Thyerja e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 18.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuara ankesa A.nr.518/2021 të datës 14.02.2021, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet gjobë në lartësi prej 600.00 (gjashtëqind) euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – Thyerja e heshtjes zgjedhore.

**II. DETYROHET** subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

PZAP-i me datën 14 shkurt 2021 ka pranuar ankesën A.nr.518/2021, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendohet se me datë 14.02.2021 në ora 13:27 një anëtarë i tyre ka pranuar një sms në telefon duke iu kërkuar ta votoj LDK-në, dhe nr.44 të listës së saj. Po ashtu është pretenduar se ky veprim është në kundërshtim me nenin 7 paragrafi b, të Rregullores së zgjedhjeve me nr.11/2013, dhe subjekti ankues të bashkangjitura me ankesë ka deponuar edhe dëshmitë.

Paneli, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e ka informuar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) lidhur me ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.

Në përgjigje në ankesë të datës 16.02.2021, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i ka kundërshtuar pretendimet e ankuesit duke theksuar se ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje nuk është e bazuar, për arsye se ankesa e parashtruar është e pas afatshme, ngase shkelja e supozuar sipas ankuesit në vetë ankesën e tyre është bërë me datë 14.02.2021 në ora 13:27, kurse ankesa është dorëzuar në PZAP, me datë 16.02.2021 në ora 10:40 dhe kjo është në kundërshtim me nenin 5.5 të rregullores nr.02/2015. Përtej kësaj në këtë ankesë është fakti se pretendimi i ankuesit, gjegjësisht prova e bashkangjitur paraqet një sms të një familjari, gjegjësisht motrës së kandidatit nga radhët e AKR-së, Jetlir Zymberaj. Elsa Zymberaj nuk është pjesë e strukturave të LDK-së nuk është anëtare e LDK-së, qoftë në degë apo nëndegë, nuk është as mbështetëse e LDK-së, por ka shkruar në cilësinë e familjares

duke theksuar se askush nuk mund ti kontrolloj dhe kufizoj lirin e promovimit për faktin se sms ka ardhur nga numri i saj personal.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuara**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave, e posaçërisht nga foto e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik LDK respektivisht mbështetësit e subjektit në fjalë, përmes SMS ka bere thirrje tek qytetaret e Kosovës që të votohet kandidati për deputet Jetlir Zyberaj, nr.44, dhe subjekti i tyre politik LDK, me nr.132, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës te Votimit për hedhjen e votës, e deri ne mbyllet e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidateve te tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), se ankesa e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, është e pas afatshme, sepse shkelja pretendohet që ka ndodhur me datë 14.02.2021 në ora 13:27, kurse ankesa është dorëzuar në PZAP, me datë 16.02.2021, këtë pretendim Paneli e refuzoi si të pa bazuar. Në rastin konkret nga prova e paraqitur me ankesë saktësisht nga sms që shihet në foto rezulton se shkelja ka ndodhur me datë 14.02.2021, ndërsa subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ankesën e ka paraqitur përmes postës po me datë 14.02.2021, që rezulton se ankesa është paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se subjekti politik LDK nuk ka dërguar asnjë SMS tek qytetaret dhe se e njëjta nuk është e implikuar në dërgimin e këtyre SMS-ve, paneli e vlerëson si jo relevante, për faktin se mesazhet janë dërguar në emër dhe për llogari të subjektit në fjalë, ku nga fotot e bashkangjitura në ankesë shihet çartë se SMS përmban numrin e subjektit politik LDK me numër rendor 132 me të cilin garoi në zgjedhjet e 14 shkurt 2021 dhe me sms iu është drejtuar qytetareve te Kosovës duke iu bere thirrje që të votohet subjekti politik LDK dhe kandidati i saj për deputet Jetlir Zyberaj, nr.44, veprime këto qe janë ne kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 36 .1 pika b) i LZP-së, ku përcaktohen veprimet e ndaluara para procesit të votimit nga ana e subjekteve politike. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), se kandidati për deputet që supozohet se ka bërë shkelje nuk është në subjektin tonë politik, por i takojnë subjektit politik AKR, paneli këtë pretendim e refuzoi si të pa bazuar. Në rastin konkret kemi sms që bënë thirrje të votohet subjekti politik LDK, si dhe kandidati në fjalë për

të cilin bëhet thirrje për tu votuar është në një listë të përbashkët me subjektin politik LDK, dhe kandidimin e ka bërë në një listë të përbashkët, andaj si e tillë konsiderohet se shkelja është bërë nga subjekti politik LDK dhe nga mbështetësit e saj.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik LDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Paneli po ashtu me rastin e përcaktimit për lartësinë e gjobës ka marrë parasysh edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik.

Paneli vlerëson se kjo mënyrë e të bërit fushatë qoftë drejtpërdrejt nga subjekti apo në emër dhe për llogari të subjektit nga mbështetësit e subjektit, cenon lirinë e përcaktimit të qytetarit duke e shqetësuar dhe duke tentuar që të ndikoj tek i njëjti për përcaktimin e tij për të votuar. Subjekti në emër dhe për llogari për të cilin është bërë thirrja për të votuar asnjëherë publikisht nuk ka mohuar se kjo fushatë është e drejtuar nga ana e tyre apo përkrahësve të tyre, por reagimi i vetëm ka qenë përmes përgjigjes së shkurtër në ankesë dërguar në Panel.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 518/2021 më datën 18.02.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,